



KRYETARI I KOMUNËS

01-Nr- 11-9065

ME DATE 27.02.2018

SHPALLJE PUBLIKE

Për angazhimin e punëtorëve me marrëveshje për shërbime të veçanta.
(Procedurë e thjeshtësuar e rekrutimit)

Komuna e Suharekës duke u bazuar në Ligjin mbi marrëdhëniet e detyrimeve, Nr. 04/L-077 neni 615 i këtij Ligji, Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës neni 12 alineja 4, si dhe bazuar në kërkesën e Drejtorisë për Bujqësi, Zhvillim rural dhe pylltari përmes marrëveshjeve për shërbime të veçanta kërkon angazhimin e punëtorëve për kryerjen e punëve për nevojat e kësaj Drejtorie.

I.Drejtoria për Bujqësi,Zhvillim rural dhe Pylltari kërkon pesë (5) Ekspert/e profesional-e për nevojat e kësaj drejtorie

Kohëzgjatja e marrëveshjes për shërbime të veçanta gjashtë (6) muaj

Paga: E negociuar

Kualifikimi:-Ing i dipl. i Bujqësisë

Detyrat dhe përgjegjësitë

1. Ndihmon në pranimin e kërkesave të bujqëve në dixhitalizimin e parcelave për subvencionim nga DPZHPB dhe MBPZHR
2. Grumbullimi i informatave për bujqësi dhe blegtori – regjistrimi i fermerëve
3. Udhëzon dhe këshillon fermerët për ngritjen e kapaciteteve në prodhimtarinë bujqësore
4. Ndihmon në organizimin e trajnive për bujqësi
5. Kryejn edhe punë të tjera sipas nevojës së drejtorisë.

Aftësitë kryesore, dituria, zotësia që kërkohet:

- Të jete person me integritet të lartë personal dhe moral;
- Aftësi të mira komunikimi ;
- Njohuri të mira të punës;

Mënyra e aplikimit:

Kandidatët e interesuar duhet të paraqesin një biografi profesionale (CV), certifikatën që ndaj tij-saj nuk janë duke u zhvilluar hetimet,kopja e letërnjoftimit kopjet e dokumentacionit për kualifikimin. Dokumentacioni i kompletuar dorëzohet në Zyrën Pritëse të Komunës së Suharekës.

Shpallja mbetet e hapur 8 ditë nga dita e publikimit në tabelën e shpalljeve dhe Web faqen e Komunës së Suharekës.

Kandidatët të cilët hyjnë në përzgjedhje të listës së ngushtë, do të informohen lidhur me intervistën (Negociimin) nëpërmjet telefonit ose me shkrim, në afat ligjor, ndërsa ata të cilët nuk hyjnë në përzgjedhjen e listës së ngushtë nuk do të kontaktohen.

Kandidatët të cilët do të jenë të përzgjedhur dhe të ftuar në intervistë (Negociim), duhet të sjellin për verifikim të gjitha dokumentet origjinale. Kërkesat e dërguara pas datës së fundit të mbylljes së shpalljes nuk do të pranohen.

Kërkesat e pakompletuara do të refuzohen.

Komuna e Suharekës ofron mundësi të barabarta për të gjithë kandidatët e interesuar.

Kryetari i Komunës

Bali Muharemaj

